



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 969/118 Prot.

Tiranë, më 14.10.2024

V E N D I M

Nr. 26, datë 14.10.2024

P Ë R

**“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT 900 MHZ (SASI SPEKTRI 4 MHZ, I ÇIFTUAR), TË SIPËRMARRËSIT ONE ALBANIA SH.A”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 14.10.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Autorizimeve shqyrtoi kërkesën me objekt:

*“Miratimin e rinovimit të autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri 4 MHz, i çiftuar) të sipërmarrësit One Albania sh.a”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 72 dhe 73, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
3. VKM nr. 496, datë 22/07/2014 “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.
4. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë Tel: +355 4 2259 571 Fax: +355 4 2259 106 [www.akep.al](http://www.akep.al); [info@akep.al](mailto:info@akep.al)

5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”.
6. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 6 datë 31.03.2022 “Për miratimin e Planit të përdorimit të frekuencave”.
7. Rregullore nr. 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.
8. VKD nr. 3 datë 25.05.2023 “Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”, i ndryshuar me VKD nr. 10 dt. 12.10.2023.
9. VKD nr. 15 datë 25.06.2024 “Për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri prej 4 MHz, i çiftuar), deri në marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negocimit me sipërmarrësin One Albania sh.a.
10. Akti i Dakordësisë, paraqitur në AKEP nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 969/15 prot. datë 17.09.2024.
11. Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr. 7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

#### KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Dokumentacioni shoqërues.

#### V Ë R E N:

1. Me Vendimin nr. 745, datë 26.06.2009, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimit individual ish sipërmarrësit Plus Communications sh.a, për përdorimit të frekuencave të brezave 900 dhe 1800 MHz dhe ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (telefoni e lëvizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë. Sasia e spektrit të alokuar ishte: 8 MHz (i çiftuar), në brezin 900 MHz dhe 9 MHz (i çiftuar), në brezin 1800 MHz.
2. Me Vendimin Nr. 22, datë 01.12.2017, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar dhënien e Autorizimeve Individuale sipërmarrësit One Albania sh.a, si rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication sh.a tek One Albania sh.a. Sipërmarrësi Plus Communication sh.a ka mbyllur rrjetin dhe shërbimet në 31.12.2017, ndërsa frekuencat e caktuara me këtë vendim, kanë filluar të përdoren nga One Albania sh.a duke filluar nga data 01.01.2018.
3. Me Vendimin Nr. 3, datë 25.05.2023 Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”, i ndryshuar me VKD Nr. 10, datë 12.10.2023. Pjesa e spektrit që mbetet tek sipërmarrësi One Albania sh.a përbëhet nga një sasi spektri prej 4 MHz (i çiftuar), në brezin 900 MHz.

4. Me shkresën nr. 969/1prot., datë 22.05.2024, sipërmarrësi One Albania sh.a, ka paraqitur aplikim për rinovimin e Autorizimit Individual për sasinë prej 4 MHz, e çiftuar, në brezin e frekuencave 900 MHz.
5. Me Vendimin nr. 13 datë 18.06.2024, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar Raportin Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 900 MHz, nga sipërmarrësi One Albania sh.a, shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.
6. Me Vendimin nr. 15 datë 25.06.2024 Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri 4 MHz, i çiftuar), miratuar me VKD Nr. 3 datë 25.05.2023 i ndryshuar, deri në marrjen e njoftimit zyrtar nga MIE mbi përfundimin e procedurës së negocimit me sipërmarrësin One Albania sh.a, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 496/2014, i ndryshuar.
7. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhrin nr. 151 datë 17.07.2024 ka ngritur Komisionin ad-hoc të Negocimit për rinovimin e Autorizimit Individual të sipërmarrësit One Albania sh.a.
8. Me shkresën nr. 969/15 prot. datë 17.09.2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka paraqitur në AKEP, Akti i Dakordësisë midis Komisionit ad hoc të Negocimit dhe sipërmarrësit One Albania sh.a. Akti i dakordësisë ka përcaktuar çmimin e rinovimit të autorizimit individual dhe disa kushte për sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit. Afati i vlefshmërisë së autorizimit të ri individual do të jetë 15 vite, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të mëparshëm të autorizimit individual.
9. Me shkresën nr. 969/17 datë 27.09.2024 sipërmarrësi One Albania sh.a, ka konfirmuar shlyerjen e pagesës së kështit të parë prej 50%, të rinovimit të autorizimit individual, në vlerën 1 434 212 (një milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e dymbëdhjetë) Euro, siç është përcaktuar në Aktin e Dakordësisë. Kësti i dytë prej 50 %, plus interesin e llogaritur me *yeld* mesatar të ponderuar të bonove të thesarit, me afat maturimi 6 mujor, të emetuar në datën më të afërt që i paraprin kryerjes së pagesës së kështit të parë, sipas Aktit të Dakordësisë, duhet të shlyhet brenda datës 30.03.2025. Vlera totale e çmimit të rinovimit të autorizimit individual në Aktin e Dakordësisë, është përcaktuar 2 868 424 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e katër) Euro.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1, neni 114 dhe pikës 1, të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 1, të nenit 112, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", bazës ligjore dhe dokumentacionit të sipërcituar, si dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP;

#### V E N D O S I:

1. Të miratojë rinovimin e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 MHz (sasi spektri 4 MHz, i çiftuar), të sipërmarrësit One Albania sh.a, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Autorizimi Individual i brezit 900 MHz, i miratuar me VKD nr. 3, datë 25.05.2023 “Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave”, i ndryshuar me VKD Nr. 10 datë 12.10.2023, zëvendësohet me Autorizimin Individual sipas pikës 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen strukturat përgjegjës në AKEP për ndjekjen e shlyerjes së pagesës nga sipërmarrësi One Albania sh.a, të këstit të dytë prej 50 %, plus interesin e llogaritur me *yeld* mesatar të ponderuar të bonove të thesarit, me afat maturimi 6 mujor, të emetuar në datën më të afërt që i paraprin kryerjes së pagesës së këstit të parë, brenda datës 30.03.2025, sipas Aktit të Dakordësisë.
4. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Tomi Frashëri</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Lorenc Bako</b>	<b>Armer Juka</b>	<b>Bleron Dokle</b>
 				